



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 011/01-13826

Dt. 21.06.2019

Dragash

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 58 të Statutit të Komunës së Dragashit, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për anulimin e konkursit nr.13/324 të datës 28.05.2019

1. Anullohet procedura e rekrutimit (konkursit) nr. nr.13/324 të datës 28.05.2019, i publikuar në Gazetën zyrtare dhe në ueb faqen e Komunës së Dragashit.
2. Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që këtë vendim ta publikojë në ueb faqen e Komunës dhe në tabelat e Drejtorisë së Arsimit me qëllim të informimit të të gjithë kandidatëve të cilët kanë qenë pjesëmarrës në këtë proces të rekrutimit.

A r s y e t i m

Meqë jemi në pjesën e fundit të përfundimit të vitit shkollor 2018/19 dhe për faktin së Drejtoria Komunale e Arsimit ka filluar procesin e analizimit dhe konsolidimit të normave mësimore në institucionet edukativo arsimore për vitin në vijim, si dhe procesin e riorganizimit të disa paraleleve të ndara në IEAA-ve, me qëllim që t i mbrojmë tepricat e mundshme të personelit arsimor në shkolla, kjo procedurë e rekrutimit **Anullohet** sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohen:

-Drejtoria e Arsimit

-Arkivi Komunal

Kryetari i Komunës
Shaban Shabani



Shaban Shabani